

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ministri Ervin Demo vlerëson angazhimin e shërbimit zjarrfikës në kryeqytet: Për sezonin tjetër, puna fillo n tani
ADRESA	https://www.balkanweb.com/ervin-demo-vlereson-angazhimin-e-sherbimit-zjarrfikes-ne-kryeqytet-per-sezonin-tjetër-puna-fillon-tani/
BURIMI	balkanweb.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 12:03:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	20 shtator 2026, 11:49:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 20 shtator 2026, 11:48:00 UTC → 20 shtator 2026, 11:50:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7be42adc5383093275d9e9362d8d043603dce3e60258cce6de158e6ee522893d
TEKSTI	2e7b3c373db61cbb200ac8d6f4435b3d790d5c29ac537477bc7338855973fd9b
PAMJA	4d4b05addc75aa15199c483f8a8a7cd247c13ee182d69f49daef282c9ec60f48

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8c2a60c22661ea8adb551ecf3a149d04df2c52189ff8b8dfe2dd647470437b56
E MËPARSHMJA	86a94ca9c737fa6f3afc9f5a8bcdfa9ea0da827f88ea752d7cbf888078f67738
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8c2a60c22661ea8adb551ecf3a149d04df2c52189ff8b8dfe2dd647470437b56>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FILLIMI

SHQIPËRIA

KOSOVA

RAJONI

SPORT

BOTA

KULTURË

METROPOL

ANALIZA

TEKNOLOGJI

Fillimi > -Politike

Ministri Ervin Demo vlerëson angazhimin e shërbimit zjarrfikës në kryeqytet: Për sezonin tjetër, puna fillon tani

20 Shtator, 2026 13:49



Madhësia e tekstit:



Ministri i Punëve të Brendshme, Ervin Demo, zhvilloi një takim me drejtues dhe punonjës të Shërbimit Zjarrfikës të Tiranës, të cilët i falënderoi për angazhimin dhe sakrificën e tyre në përballimin e situatave emergjente gjatë sezonit të zjarreve dhe gjatë gjithë vitit.

Ministri Demo vlerësoi rolin e zjarrfikësve në garantimin e sigurisë së qytetarëve, duke theksuar se shërbimi zjarrfikës përballet jo vetëm me zjarret, por edhe me një numër të lartë emergjencash të tjera, nga aksidentet rrugore deri te ndërhyrjet në situata të ndryshme rreziku.

“Në ADN-në e trupave të zjarrfikësës është shërbimi ndaj qytetarëve. Është një profesion që, në momentin që kjo ndjenjë ekziston, ajo çfarë ju jepni si impakt në territor është e jashtëzakonshme”, u shpreh ministri Demo.

Duke u ndalur te specifikat e Tiranës, ministri vuri në dukje rëndësinë e forcimit të strukturave vullnetare, veçanërisht në zonat periferike të bashkisë, për të përballuar më mirë situatat emergjente.

“Tirana është një bashki e madhe dhe nuk është vetëm një zonë urbane. Trupat vullnetare, sidomos në rrethinat e Tiranës, kanë një rol



Kërko ketu

LAJMET E FUNDIT



VIDEO/ “Buzëqesh” Dinamo, thyen Laçin

19 Shtator, 2026



VIDEO/ 4 gola në supersfidën e Serie A, Inter dhe Roma bëjnë paqe

19 Shtator, 2026



VIDEO/ Kampionët e Anglisë bien ndaj Brighton, disfatë e hidhur për Arsenalin

19 Shtator, 2026



“Mbështetje të plotë nga SHBA/ Berisha: Lufta kundër narkoshtetit dhe trafikeve, në fokus të takimeve tona

19 Shtator, 2026



Akuzohen se regjistruan një sipërfaqe toke në emër të biznesmenit, dalin para gjykatës dy ish-drejtuesit e ASHK-së së Fierit, specialisti dhe përfituesi

19 Shtator, 2026



“E kanë në dorë kryeministrin/ Berisha: Balluku, Agasi e Beqiri janë padronët në krim”

19 Shtator, 2026

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



akoma edhe më të rëndësishëm”, tha Demo, duke sjellë si shembull modelin e organizimit të shërbimit vullnetar të zjarrfikësve në Austri.

Ministri theksoi gjithashtu se përballimi i emergjencave ^xkërkon bashkëpunim të ngushtë mes bashkive dhe strukturave shtetërore, duke vlerësuar solidaritetin e zjarrfikësve të Tiranës në ndërhyrjet përtej territorit të kryeqytetit.

“Kemi pasur zjarre në bashki të ndryshme në vend, ku ju keni marrë pjesë dhe keni luftuar bashkë me kolegët tuaj, duke mbrojtur ato komunitete, duke ruajtur pasurinë publike dhe private”, u shpreh ai.

Demo vlerësoi punën e bërë për forcimin e shërbimit zjarrfikës në kryeqytet, jo vetëm përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore, por edhe përmes përmirësimit të aftësive profesionale dhe bazës logjistike.

“Më vjen shumë mirë që në kryeqytetin tonë ky shërbim, ditë pas dite, muaj pas muaji, vit pas viti, është duke u përforcuar, jo thjesht duke rritur numrat, por dhe duke rritur aftësitë profesionale dhe logjistikën mbështetëse”, tha ministri.

Një tjetër fokus i diskutimit ishte nevoja për të kaluar nga një qasje e përqendruar vetëm te reagimi ndaj zjarreve, drejt një politike më të fortë parandaluese. Demo tha se Ministria e Punëve të Brendshme do të punojë me bashkitë dhe strukturat e Emergjencave Civile për një plan më të qartë për sezonin e ardhshëm.

“Ne duhet të bëjmë shumë më tepër që të minimizojmë rastet ku ndërhyrja e zjarrfikësve është e nevojshme. Kjo ka të bëjë me menaxhimin e pyjeve, kullotave dhe gjithë masave të tjera që duhet të ndërmarrim”, theksoi ai.

Sipas ministrit, në bashkëpunim me Drejtoritë e Emergjencave dhe të gjitha bashkitë e vendit, do të hartohet një plan i përbashkët për përgatitjen e sezonit të ardhshëm të zjarreve, me synim rritjen e gatishmërisë dhe minimizimin e situatave të rrezikshme.

Në përfundim të takimit, ministri Demo shprehu mirënjohjen për zjarrfikësit dhe familjet e tyre, duke vlerësuar kurajon dhe vetëmohimin e tyre në përmbushjen e misionit.

“Në thelb të këtij shërbimi jeni ju, janë zjarrfikësit, të cilët shpeshherë edhe me vetëmohim dhe me një kurajo përtej atyre vlerave normale, janë gati të vetësakrifikohen për të ndihmuar qytetarët që janë në rrezik”, u shpreh ministri i Punëve të Brendshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Ervin Demo zjarrfikës

TË NGJASHME



Ministri Demo në Rinas me Policinë Kufitare: Mirënjohje për përballimin efikas të fluksit rekord të udhëtarëve (VIDEO)
20 Shtator, 2026



VIDEO/ Përfshihet nga flakët një anije në Portin e Shëngjinit, forcat zjarrfikëse drejt vendngjarjes
05 Shtator, 2026

TË FUNDIT NGA -POLITIKË



20 Shtator, 2026

Protestat për largimin e Ramës në ditën e 113-të/ Thirrja e fortë e aktore Eglja Ceno: Kush është shqiptar e di vetë se ku duhet të jetë. Dëgjoni instiktin, zgjidhni dinjitetin



Shqiptarët bashkohen në Kalabri, nga trashëgimia arbëreshe te mesazhi "Liri për çlirimtarët"
20 Shtator, 2026

Revolta kundër qeverisë nuk ndalet/ Mbahet sot protesta e 113-të! Qëndresa vazhdon, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Ramës
20 Shtator, 2026

VIDEO/ "Nesër më shumë", mbyllet protesta e 112 kundër qeverisë, qytetarët të vendosur: Rama jepe dorëheqjen
19 Shtator, 2026

"Apartamente, vila, makina, jahte, prona, euro, lekë dhe..."/ Ish-deputeti Halit Valteri 'godet' Ballukun: Duhet t'i vendosim kufi kësaj kuçedre që ha burra dhe po përpin pushtetin

19 Shtator, 2026

"Për Enverin yll e dritë... Qajnë pleqtë qajnë të rinjtë"/ Korreshi ndan videon: Skandal në Lushnje, në ambientet e muzeut glorifikohet diktatori (VIDEO)

19 Shtator, 2026

KATEGORIA VIDEO



VIDEO/ "Buzëqesh" Dinamo, thyen Laçin
19 Shtator, 2026



VIDEO/ 4 gola në supersfidën e Serie A, Inter dhe Roma bëjnë paqe
19 Shtator, 2026



VIDEO/ Kampionët e Anglisë bien ndaj Brighton, disfatë e hidhur për Arsenalin
19 Shtator, 2026



"Mbështetje të plotë nga SHBA"/ Berisha: Lufta kundër narkoshtetit dhe trafiqeve, në fokus të takimeve tona
19 Shtator, 2026



19 Shtator, 2026

Akuzohen se regjistruan një sipërfaqe toke në emër të biznesmenit, dalin para gjykatës dy ish-drejtnesit e ASHK-së së Fierit, specialisti dhe përfutuesi



19 Shtator, 2026

"E kanë në dorë kryeministrin"/ Berisha: Balluku, Agasi e Beqiri janë "padronët në krim". Çfarë i tha Lubia në takim Ramës kur SPAK kërkoj arrestimin e saj

BalkanWebj

FAQET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

KONTAKT

Focus Media News shpk

NUIS/NIPT K21909002K

Privacy Policy

Contact

Email:

EMISIONE NEWS24

Autoktonët

Emisioni Vila 24

Fit Station

Kjo Javë

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Në shënjester

News24 Fundjavë

Oponencë

Podcast

Sport News

Studio 24

Tak Fak

Vetting

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.